



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:220922  
Datë: 16.05.2024  
Numri i dokumentit: 05694043

A.nr.2478/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditëses, M.C., nga Komuna e ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson ..., avokat nga ... kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) në Prishtinë, për shkak të anulimit vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në mungesë të dy palëve ndërgjyqëse, me datë 18.04.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses, ..., nga Komuna e ... me të cilën ka kërkuar që të aprovohet padia e saj si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me nr. A.nr.186/2019 i datës 30.10.2022, ashtu që të detyrohet i padituri që paditësen ta kthej në vendin e punës dhe ti bëhet kompensimi i pagave, si e pa bazuar.

II. Shpenzimet procedurale i bartë secila palë veta në procedurë.

**A r s y e t i m**

Me datën 24.04.2024 është mbajtur shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridiko-administrative, në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në mungesë të palëve ndërgjyqëse të ftuara në mënyrë të rregullt gjyqësore.

Paditësja me padinë e datës 26.10.2022 ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e saj si te bazuar dhe të anulohet vendimin e të paditurit të datës 30.10.2022, ashtu që të detyrohet i padituri që paditësen ta kthej në vendin e punës Daktilogafe dhe ti bëhet kompensimi i pagave duke filluar nga muaji gusht i vitit 2014, e deri në ditën e kthimit në punë, me kamat sipas norme 8%, shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 15 ditsh pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

I padituri, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në përgjigjen në padi të datës 14.12.2024, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pa bazuar dhe ta vërtetojë vendimin e Këshillit me nr. A.nr.186/2019 i datës 30.10.2022, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 18.04.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi i dt.13.10.2022 me numër A.nr.186/2019; Aktgjykimi i dt.01.05.2021 me numër A.nr.1515/2019; Akti i lëshuar nga Komuna e Leposaviqit e dt.01.09.2013 numër 148A/13; llogaria e dt.01.04.2014 deri 30.04.2014; 01.05.2014-31.05.2014; 01.06.2014-30.06.2014; vendimi i dt.03.02.2015 numër A 02/531/2014; shkresa e dt.04.11.2014; shkresa nga zyra E Auditorit te Përgjithshëm; dëftesa për pranimin e dërgesës me numër 259012014618078 e dt.10.09.2014; shkresa e dt.09.09.2014; kopja e kartelës – shkresa e dt.01.10.2014; shkresa e dt.25.09.2014;dëftesa për pranimin e dërgesës me numër 259012014619838 e dt.01.10.2014; shkresa e dt.30.09.2014;kopja e letërnjoftimit për paditësen e dt.15.07.2011; shkresa e dt.03.10.2014;formulari i regjistrimit; shkresa e dt.22.11.2014 e protokolluar me dt.01.12.2014; shkresa e dt.10.12.2013; vendimi i dt.20.12.2013 me numër 118-157; shkresa e dt.31.07.2014; formulari i dt.01.08.2014;përgjigja ne padi e dt.12.11.2018 me numër reference A 02/527/2015; Aktgjykimi i dt.06.02.2019 me numër A.nr.430/15 d; kërkesa per shqyrtimin e ankesës e dt.08.05.2018; shkresa e dt.02.03.2015; përgjigja lidhur me ankesat e dt.15.05.2019 me numër reference 2220/2019;njoftimi lidhur me ankesën i dt.16.09.2019 me numër reference A.nr.186/2019 dhe shkresa e dt.13.10.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës së kësaj çështje administrative, konstatoi se padia është e pabazuar.

Me vendimin e të paditurës, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër A.nr.186/2019 të datës 13.12.2022, është refuzuar si e pa bazuar ankesa me numër A/02/531/2014 e datës 04.11.2014, e parashtruar nga ankuesja këtu paditëses, ...,

Kundër vendimit kontestues të paditurës, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, paditësja ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 26.10.2022, duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi i'u referua dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenit 3 paragrafit 2 ku përcaktohet se, 2. Nëpunësit civil punësohen në bazë të meritës, pasi t'i jenë nënshtruar procedurës përzgjedhëse, e

përcaktuar në bazë të këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore, ndërsa neni 19 i te njetit ligje përcakton se, nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike, në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil. Andaj në vështrim të kësaj dispozite gjykata ka konstatuar pranimi në shërbimin civil bëhet vetëm nëpërmes procedurës së caktuar të rekrutimit duke marrë parasysh se emërimi i paditëses në pozitën “daktilografes” në komunën e ...është bërë pa ndonjë procedurë pranimit, nga se nuk është ofruar asnjë provë nga të gjitha palët në procedurë e e njëjta në mënyrë të ligjshme e ka fituar këtë pozite të nëpunëses civile andaj në këtë kuptim pretendimi i paditëses është si i pa bazuar.

Me tej, sipas ligjit nr.05/L031 për Procedurën Administrative përkatësisht neni 51, ku citon se, një akt mund të anulohet apo shfuqizohet sipas detyrës zyrtare nga organi publik që ka kompetenca të nxjerr aktin, nëse akti i tillë është nxjerr me ndonjë nga shkeljet e paracaktuara, ndërsa me nenin 52 të njëjtit ligj citon, “një akt administrativ është i paligjshëm nëse,,1.3 është rezultat i shkelje si dispozitave lidhur me procedurën ankimit,, 1.5 është në kundërshtim me ligjin material e mbi këtë bazë si dhe duke u nisur nga konstatimi si me lart se emërimi i paditëses në pozitën e lartcekur është bërë pa procedurë të rekrutimit, dhe me qenë se nuk jam zbatuar dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil dhe asnjë akt administrativ që derivon nga një proces administrativ i paligjshëm nuk mund të prodhojë pasojë juridike.

Nga kjo gjykata bazuar nga administrimi i provave ka konstatuar se paditësja nuk ka arritur me asnjë dëshmi të provojë se këtë pozite e ka fituar konform Ligjit për Shërbimin Civil dhe po ashtu e njëjta nuk i ka ofruar gjykatës që konfirmohet se njëjta ka punuar pas periudhës 03.10.2013, ngase prezenca në punë duhet të vërtetohet me listë të vijimit në punë e nënshkruar nga i punësuar apo përmes sistemit elektronik e që nga paditësja nuk është ofruar si dhe asnjë dokument zyrtar sa i përket kësaj çështje dhe në këtë kuptim kjo çështje ka qenë e rregulluar me nenin 59 të Ligjit për Shërbimin Civil i cili përcakton se, nëpunësit civilë janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit të tyre dhe gjatë orarit të përcaktuar për funksionimin e institucionit punëdhënës. Nëpunësit civilë janë të detyruar të respektojnë orarin e punës dhe ta shfrytëzojnë atë për kryerjen e detyrave të caktuara. 2. Nëpunësit civilë janë të detyruar t'i informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës. Mos informimi ose mungesa e pa lajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet në përputhje me ligjin, andaj nga kjo nuk mund të kërkojë pagë për punë që nuk është kryer sipas Ligjit për Paga nr. 03/L-147 respektivisht neni 5 paragrafi 1 i cili citon se paga bazë sipas këtij ligji është rezultat i çmimit të punës dhe paga bazë sipas këtij ligji është rezultat i angazhimit dhe përkushtimit të nëpunësve civilë në pozitën e punës,, dhe po ashtu mungesa në punë 2 ditë pa arsye është shkelje e rëndë serioze e parapar në nenin 6 paragrafi 1.13 dhe neni 8 të Rregullores nr. 04/2011, andaj në vështrim të këtyre dispozitave

është vlerësuar se paditësja nuk ka ofruar asnjë provë dhe nuk ka arrit të dëshmoj se e njëjta ka punuar gjatë periudhës kur e kërkon kompensimin andaj ky pretendim i paditëses është i pa bazuar.

Nga kjo punëdhënësi ka vlerësuar në mënyrë të drejt duke marr parasysh provat dhe gjendjen faktike, ku me të drejt ka vendosur që të njëjtës i ka ndërprerë marrëdhënies e punës dhe heqjes nga lista e pagave, në vështrim të dispozitave të lartcekura.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Paditësi me asnjë provë nuk dëshmon pretendimet e tij, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative-juridike. Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditësit sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në kuptim të nenit 64 të LKA.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 2478/2022 data 18.04.2024

G j y q t a r e  
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.